



KUVENDI I KOMUNËS

Ekstrakt

nga procesverbali i mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit të Komunës së Podujevës, mbajtur më 18 janar 2018.

Mbledhja filloi në orën 10:00 dhe u mbajt në sallën e Kuvendit.

Mbledhjen e kryesoi z.Mehmet Gashi, anëtar më i moshuar i Kuvendit të Komunës.

Në mbledhje të pranishëm ishin të gjithë anëtarët/et e këshilltarë/e të Kuvendit të Komunës.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë dhe vendimmarrje.

Gjithashtu në mbledhje të pranishëm ishte z.Agim Veliu Kryetar i Komunës së Podujevës.

Në sallë të pranishëm ishin edhe një numër i zyrtarëve dhe ish zyrtarëve të Komunës, përfaqësues të institucioneve të Komunës, përfaqësues të OSBE-së, përfaqësues nga Organizata të ndryshme Joqeveritare, disa përfaqësues të mjeteve të informimit, dhe një numër i konsideruar i qytetarëve.

Rendi i ditës

z.Mehmet Gashi, Kryesues i mbledhjes, përshëndeti të pranishmit, theksoi, e hapi mbledhjen e dytë të Kuvendit, fillimisht në bazë të nënshkrimeve në listën përkatëse konstatoj se të gjithë këshilltarët e Kuvendit janë prezent në sallë, andaj kuorumi ekziston dhe mund të vazhdojmë me punë. Thirrja e kësaj mbledhje u është dërguar me kohë dhe sikurse jeni në dijeni se në bazë të dispozitave ligjore, rendi i ditës në mbledhje të jashtëzakonshme të Kuvendi nuk mund të plotësohet apo ndryshohet, andaj ju lutem a pajtoheni të vazhdojmë me punë.

U konstatua se njëzëri u miratua rendi i ditës

Kryesuesi i mbledhjes, Tani vazhdojmë me punë, dhe në radhë kemi pikën

1. Dhënia e betimit nga këshilltarja e Kuvendit znj.Donjeta Jakupi,

z.Mehmet Gashi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, para se këshilltarja e cekur të jap betimin, ftoj Komisionin për verifikimin e mandatit të këshilltarëve të Kuvendit, të verifikoj mandatin e këshilltares znj.Donjeta Jakupi, dhe të paraqet raportin përkatës.

Pas verifikimit të mandatit të këshilltares së Kuvendit znj.Donjeta Jakupi nga Komisioni prej 3 anëtarëve (Avni Fetahu, Doruntina Hasani dhe Fatmir Rudari), në emër të Komisionit u paraqit raporti nga,

z.Avni Fetahu, i cili theksoi, duke u bazuar në dokumentacionin e Komisionit Qendrorë të Zgjedhjeve – KQZ, përkatësisht Vendimin nr.2382-2017, si dhe përgjigjes së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, znj.Donjeta Jakupi është këshilltare e Kuvendit të Komunës së Podujevës nga radhët e subjektit politik PDK, të cilës i urojmë punë të mbarë.

Kryesues i mbledhjes, falënderoi Komisionin, dhe fton znj.Donjeta Jakupi të ngritët në këmbë për dhënien e Betimit.

Këshilltarja e lartpërmendur, me tekstin si në vijim jep Betimin solemn,

Unë, Donejta Jakupi betohem se do t'i kryejë me nder, me besnikëri, pa anime e me ndërgjegje dhe sipas ligjit detyrat dhe do t'i ushtrojë autorizimet e mia si këshilltare e Kuvendit të Komunës së Podujevës, në mënyrë që të sigurohen kushte për jetë të qetë për të gjithë.

z.Mehmet Gashi, Kryesuesi i mbledhjes, theksoi, urime dhe suksese e nderuar, tani edhe zyrtarisht jeni këshilltare e Kuvendit të Komunës së Podujevës, Vazhdojmë me punë me pikën e dytë të rendit të ditës.

2. Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit

Kryesuesi i mbledhjes, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, sipas proceduarave ligjore, fillimisht duhet të;

- **Ngritët Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit,**

Në bazë të nenit 2.3 të UA nr.2009/01 për procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësit e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, parashihet që Komisioni në fjalë të përbëhet prej 3 deri 5 anëtar të Kuvendit, i cili është përgjegjës që të numëroj votat dhe t'i komunikoj rezultatet e votimit para anëtarëve të Kuvendit të Komunës, dhe çështje tjera procedurale, andaj nëse pajtoheni, propozoj që ky Komision të përbëhet prej 3 anëtarëve dhe atë nga subjektet politike me numrin më të madh të këshilltarëve, përkatësisht nga radhët e LDK-së, LVV-së dhe PDK-së. Pra unë propozova këtë përbërje duke u bazuar në praktikat e mëparshme, nëse pajtoheni që ky Komision të përbëhet prej 3 anëtarëve, mund të votojmë, nëse jo atëherë mund të shkojmë me 5 anëtarë.

E hedh në votim

Pas votimit u konstatua se njëzëri u mbështetë propozimi që Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të përbëhet prej 3 anëtarëve dhe atë, një anëtarë nga radhët e LDK-së, një anëtarë nga radhët e LVV-së dhe një anëtarë nga radhët e PDK-së.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, në vazhdim, ftoj përfaqësuesit e subjekteve të: LDK-së, pastaj LVV-së dhe PDK-së, të propozojnë anëtarët për këtë Komision.

z.Avni Fetahu, theksoi, në emër të Grupit të këshilltarëve të Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit Lidhja Demokratike e Kosovës, propozojmë z.Hasan Ajetin.

z.Bajram Ajeti, theksoi, nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, propozoj z.Florent Hasanin.

z.Fatmir Rudari, theksoi, në Komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit për zgjedhjen e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës, nga radhët PDK-së, propozojmë z.Rafet Llapashticën.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, falënderoj parafolësit për propozimet e dhëna. Tani e hedh në votim ngritjen përkatësisht përbërjen e Komisionit në fjalë duke përfshirë edhe propozimet e dhëna nga përfaqësuesit e 3 subjekteve politike.

Pas votimit u konstatua se njëzëri ngritët Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit për zgjedhjen e kryesuesit të Kuvendit, në këtë përbërje:

- Hasan Ajeti, nga radhët e subjektit politik LDK
- Florent Hasani, nga radhët e subjektit politik LVV, dhe,
- Rafet Llapashtica, nga radhët e subjektit politikë PDK

z.Mehmet Gashi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, tani mund të vazhdojmë me punë, përkatësisht me nënpikën,

- **Propozimi i kandidatëve**

Ju përkujtoj se propozimet e kandidatëve për kryesues të Kuvendit mund t'i bëjnë: subjektet politike në kuadër të përbërjes së Kuvendit, ndonjë Grup i këshilltarëve si dhe këshilltarët në mënyrë individuale, andaj ju lutem radha është të paraqiten propozimet e Juaja, dhe mund të fillojmë me subjektet politike të përfaqësuara sipas radhës në këtë Kuvend:

z.Avni Fetahu, theksoi, Grupi i këshilltarëve të Kuvendit të Komunës së Podujevës nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës – Dega në Podujevë, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës së Podujevës të datës 18.01.2018, për kryesues të Kuvendit të Komunës së Podujevës në legjislaturën e VI të Kuvendit, propozon z.Fatmir Gashin, me profesion, profesor për mbrojtje dhe siguri.

Në vazhdim, më lejoni të paraqesë një biografi të shkurtër të z.Fatmir Gashit.

z.Fatmir Gashi, është i lindur më 10.08.1958 në fshatin Dobërdol, Komuna e Podujevës, i martuar dhe babë i dy fëmijëve. Nga viti 1983 deri në vitin 2000 ishte profesor në disa shkolla të mesme në Prishtinë dhe Podujevë, në lëndën, mbrojtje dhe siguri. Nga viti 2001 deri në vitin 2007 ishte drejtor i Drejtorisë për Mbrojtje Civile dhe Emergjencë në Komunën e Podujevës, nga viti 2007 deri në vitin 2009 ishte këshilltar në Kuvendin e Komunës së Podujevës, pastaj nga viti 2009 deri në vitin 2013 ishte drejtor i Drejtorisë së Inspeksionit në Komunën e Podujevës, ndërsa nga viti 2013 deri në vitin 2017 ishte drejtor i Drejtorisë së Administratës në Komunën e Podujevës, aktualisht është këshilltar i zgjedhur në Kuvendin e Komunës së Podujevës.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i mbledhjes, tani ftoj subjektet tjera politike, individ apo Grupe të këshilltarëve, sipas radhës të paraqesin propozimet e tyre.

z.Bajram Ajeti, theksoi, të nderuara asambleiste dhe asambleist, ne Grupi i asambleistëve të Kuvendit të Komunës, nga radhët e subjektit politikë Lëvizja Vetëvendosje, nuk kemi propozim për kryesues të Kuvendit të Komunës së Podujevës, për një arsye jo të vetme, duke marrë parasysh se partia e cila ka pozitën nuk po mund të largohet nga pazarllëqet për të blerë e shitur, kështu që ne nuk do të futemi në këto pazare, dhe nuk kemi kandidat për të propozuar.

z.Rafet Llapashtica, theksoi, Grupi i këshilltarëve nga radhët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, nuk ka propozim për kandidat për kryesues të Kuvendit të Komunës.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, nëse ka të interesuar tjerë për të paraqit ndonjë propozim për kandidat për kryesues të Kuvendit, mund të marrë fjalën, nëse jo atëherë në bazë të propozimeve të paraqitura konstatohet se kandidat për kryesues të Kuvendit është z.Fatmir Gashi, pra kemi vetëm një kandidat dhe mund të vazhdojmë me punë.

E ftoj Komisionin për mbarëvajtjen e procesit të votimit, që në bashkëpunim me zyrën për punë të Kuvendit të përgatitin fletëvotimet me emër dhe mbiemër të kandidatit për kryesues të Kuvendit, në mënyrë që të fillohet me procesin e votimit të fshehtë sipas legjislacionit në fuqi, mirëpo deri në

përgatitjen e materialit të cekur, propozoj një pauzë të shkurtë prej 15 minuta, pastaj fillojmë me procesin e votimit.

Pauzë fillon në ora: 10;15

Pas përfundimit të pauzës, mbledhja vazhdoi në ora 10;35 ku prezent ishin të gjithë këshilltarët e Kuvendit.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, në vazhdim kemi nënpikën,

- **Procesi i Votimi**

I cili fillon duke thirrë këshilltarët e Kuvendit emër për emër të cilët nënshkruhen në listën e votimit, marrin fletëvotimin e vulosur për të votuar, dhe pas përfundimit të votimit, Komisioni paraqet raportin.

Atëherë nëse komisioni është i gatshëm të fillojmë me këtë proces, mund të fillojmë.

Fillon procesi i votimit.

z.Bajram Ajeti, theksoi, atë që e thash më parë duke paraqitur qëndrimin që ne si Lëvizje Vetëvendosje dhe si Grup i këshilltarëve në këtë përbërje të Kuvendit, kemi menduar që opozita do të jetë e bashkuar, mirëpo me sa po shihet dhe sipas informacioneve nuk është në atë nivel që do të duhej të ishte sepse nuk është në atë për çfarë edhe i ka kërkuar votat dhe të jetë në shërbim të qytetarëve, kështu që Grupi i këshilltarëve nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje nuk do të votoj fare.

z.Fatmir Rudari, theksoi, po ashtu është vendim edhe i subjektit Partia Demokratike e Kosovës që mos të marrë pjesë në këtë votim.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, ne veç filluam me votim, edhe pse dy parafolësit e morën fjalën, mirëpo dëshiroj t'jua përkujtoj të gjithë kolegëve anëtarë të Kuvendit të cilët sigurisht edhe janë në dijeni për pasojat që parashihen sipas ligjit në rast të mos zgjedhjes së Kryesuesit të Kuvendit brenda afatit prej 30 ditëve nga inaugurimi i Kuvendit, kështu që nuk di a i konvenon një gjë e tillë ndokujt prej nesh. Si do që të jetë vazhdojmë me votim dhe ftoj emër për emër këshilltarët e Kuvendit sipas radhës.

Kryesuesi i mbledhjes, thërret një nga një këshilltarët e Kuvendit, ku ata të cilët votojnë, dalin te Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit, nënshkruhen në listën përkatëse, marrin fletëvotimin dhe votojnë.

Pas votimit nga këshilltarët që votuan, Komisioni fillon numërimin e votave, dhe pastaj i njëjti paraqet,

- **Raport rreth mbarëvajtjes së procesit të votimit, dhe i njëjti komunikon rezultatet e votimit.**

z.Mehmet Gashi, Kryesues i mbledhjes, fton përfaqësuesin e Komisionit të paraqet raportin nga procesi i votimit dhe njëkohësisht të komunikoj rezultatet e votimit.

z.Hasan Ajeti, në emër të Komisionit, paraqiti raportin, theksoi, të nderuar të pranishëm, Komisioni për mbarëvajtjen e procesit të votimit në bazë të listës së nënshkrimeve dhe numrit të fletëvotimeve konstaton se:

Kanë votuar gjithsej 18 këshilltarë të Kuvendit,

Fletëvotime të vlefshme janë 18,

Për, janë 18 vota,

Kundër nuk ka, andaj,

Konstatohet se me 18 vota për, z.Fatmir Gashi, zgjedhet Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës.

z.Mehmet Gashi, Kryesues i mbledhjes, theksoi, në bazë të raportit të Komisionit për mbarëvajtjen e procesit të votimit për Kryesues të Kuvendit,

Konstatohet se;

z.Fatmir Gashi, me 18 vota për, zgjedhet Kryesues i Kuvendit të Komunës së Podujevës, në legjislaturën e VI-të të Kuvendit të komunës së Podujevës.

I përmenduri nga ky moment merr detyrën e tij në cilësinë e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Podujevës.

Urime i nderuar, urdhëroni që tani mund ta merrni detyrën.

➤ **Fjalë rasti e z.Fatmir Gashi, Kryesues i sapo zgjedhur i Kuvendit të Komunës së Podujevës.**

I nderuar z.Agim Veliu, Kryetar i Komunës, Kryesues i mbledhjes z.Mehmet Gashi, të nderuara këshilltare dhe këshilltarë të Kuvendit të Komunës dhe të gjithë të pranishmit tjerë në sallë, Ju faleminderit për besimin e dhënë, veçanërisht falënderoj të gjithë ata të cilët morën pjesë në procesin e votimit dhe që më besuat një detyrë kaq të rëndësishme dhe të shenjt për mua dhe për këtë Kuvend. Jam shumë i bindur që do ta vazhdojmë traditën e mirë të Kuvendit të Komunës së Podujevës, këtë e them për arsye se vlerësimet për Kuvendin e Komunës së Podujevës që nga themelimi i tij, fjala është nga paslufta, janë se është një Kuvend i cili vazhdimisht ka kryer me sukses detyrat e veta ligjore me punë, debate dhe angazhime tjera të nevojshme, çka e bënë të jetë një prej Kuvendeve me vlerësimet më të mira.

Unë nuk dyshoj në asnjërin prej këshilltarëve koleg dhe kolege të këtij Kuvendi sa i përket angazhimeve në shërbim të qytetarëve dhe kryerjes së detyrave dhe përgjegjësiave tona të parapara me ligje dhe akte nënligjore në fuqi.

Ju quajta kolege dhe kolegë, duke pasuar para sysh se të gjithë ne këtu jemi të barabartë, por që mua përkrhja, fati dhe mbështetja Juaj më mundësoi të jem Kryesues i Kuvendit, mirëpo parasë gjithash e përsërisë se të gjithë jemi të barabartë në shërbim të të gjithë qytetarëve të cilët na kanë besuar dhe na kanë mbështetur të jemi përfaqësues të tyre në këtë Kuvend.

Edhe njëherë Ju faleminderit të gjithëve, uroj të na përcjellë shëndeti dhe sukseset.

Meqë në kuadër të rendit të ditës nuk pati pika tjera të parapara, Kryesues i sapo zgjedhur i Kuvendit të Komunës z.Fatmir Gashi, e konstatohet të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në ora 10:50

Procesverbalin e mbajti

Enis Sheholli

Nr.01-060/04-0004479/18

Podujevë,

18 janar 2018

Kryesuesi i mbledhjes

Mehmet Gashi